

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ANONIME "AGROTAL 1" SH.A**



Me cilesine e aksionereve themelues :

1. Aksioneri Artur Dojaka i biri i harunit i dtl.06.06.1970 lindur dhe banues ne Tirane mbajtes i pass nr.0321392.
2. Aksioneri Ioakim Bedo i biri i Jorgos i dtl.18.04.1964 lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane mbajtes i pass.Z1232508.

Mbeshitetur :

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,

Ne ligjin 7638 date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare ",

Ne ligjin nr. 7667 date 28.01.1993, " Per regjistrin tregtar", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, kane themeluar nje Shoqeri Anonime me emertimin "AGROTAL 1" sha,

(me poshte e quajtur "Shoqeria ")

KAPITULLI I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "AGROTAL 1 " sha, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri Anonime pa Oferte Publike (me poshte e quajtur "Shoqeria").

NENI 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në gjykatën kopetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "AGROTAL 1 " sha, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në aksione dhe që themelohet ndërmjet aksionereve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, Shqiperi, ne adresen Rr "Pjeter Bogdani i ri" godina 2-6 kate,kati 2 zyra nr.1.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Jashtëzakonshme.

Neni 4

Objekti

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Agrobiznesit, prodhim dhe tregtim vaji, kultivim te ullirit dhe bimeve te tjera qe lejohen nga ligji.

Import-eksport dhe tregtim me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, artikuj bujqesor dhe blegtorale, pajisje elektronike, elektrike, informatike, elektroshtepiake, metrazhe, lende kimike, bime medicinale.

Prodhim dhe tregtim te artikujve te ndryshme mobilerie, dyer, dritare, artikuj duralumini, tregtim pajisje zyre, kanceleri, apjisje ventilimi dhe kondicionimi.

Tregtim medikamentesh dhe barnash mjekesore, pajisje diagnostikuese dhe aparatura te ndryshme mjekesore.

Agjensi udhetimesh turistike. Agjensi imobiliare. Agjensi shitje biletash te transportit urban, hekurudhor, ajror dhe detar.

Realizimi I qellimeve te shoqerise mund te arrihet nga shoqeria vecmas ose ne bashkepunim me persona privat ose juridik te cfare do lloj forme, te cilet kane qellime te njejta ose te peraferta, brenda ose jashte vendit me pjesmarrjen e shoqerise ne forma te ndryshme juridike, te cilat ekzistojne ose do te themelohen, ose me bashkim me shoqeri te tjera qe kane qellime te njejta ose te peraferta.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqiptar.

KAPITULLI II.

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 2.000.000 Leke dhe eshte i ndare ne 2000 aksione me vlere nominale 1.000 (njemije) Leke shqiptare secili. Kapitali i shoqerise nenshkruhet dhe derdhet teresisht ne te holla nga aksioneret e shoqerise perkatesisht:

1. Aksioneri Artur Dojaka aksione me vlere te pergjithshme 1.000.000 Leke, qe perbejne 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Aksioneri Ioakim Bedo aksione me vlere te pergjithshme 1.000.000 Leke, qe perbejne 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Aksionet jane teresisht nominale dhe jane lirisht te transferueshme sipas ligjit shqiptar ne fuqi dhe me te drejte parablerje;

Aksioneret pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Çdo aksion i jep te drejten e nje vote titullarit te tij;

Me vendim te Asamblese se Jashtzakonshme, kapitali i shoqerise mund te rritet dhe zvogelohet,

sipas menyrrave te parashikuara ne ligj.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në paragrafin e pare, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbliidhet për të marrë vendim.

KAPITULLI III.

Neni 7

Administrimi

Shoqëria Administrohet nga Keshilli Mbikqyres dhe nga Drejtoria. Secili nga keto organe drejtuese ka kompetencat qe i cakton Statuti dhe legjislacioni ne fuqi.

Shoqëria mund te drejtohet nga një drejtori e përbërë nga një ose disa anëtarë.

Drejtor i pare i shoqërisë është **znj. Tamara Agolli**.

Drejtoria ushtron funksionet e saj nën kontrollin e Këshillit Mbikëqyrës. Anëtarët e drejtorisë/drejtori, mund të shkarkohen për shkaqe të përlijura nga këshilli mbikëqyrës.

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres te nominuar nga aksioneret jane:

1. Artur Dojaka (Kryetar)
2. Ioakim Bedo(N/Kryetar)
3. Laureta Qorlazja (Anetar).

Neni 8

Pergjegjesia Personale

Pasuria e aksionereve, drejtoreve, punonjesve dhe/ose agjenteve te Shoqërisë, është e perjashtuar nga çfaredo lloj detyrimi qe rendon mbi Shoqërine.

Neni 9

Ekspertet Kontabel te Autorizuar

Mbledhja e Asamblese se Aksionereve, emeron nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar. Çdo ekspert kontabel i autorizuar do te qendroje ne kete detyre per nje vit financiar te shoqërisë. Funksionet e tyre përfundojnë pas mbledhje së asamblesë së zakonshme, e cila merr vendim mbi llogaritë vjetore. Eksperti kontabël i autorizuar, i emëruar nga asambleja për zëvendësimin e një tjetri, mbetet në funksion deri në fundin e mandatit të paraardhësit të tij.

Në qoftë se asambleja lë pas dore zgjedhjen e një eksperti, çdo aksionar mund të kërkojë caktimin e një eksperti kontabël të autorizuar në rrugë gjyqësore; në këtë rast gjykata thërret sipas rregullave drejtorin e drejtorisë. Kështu mandati i caktuar përfundon kur mbledhja e asamblesë ka marrë masat për emërimin e një ose të disa ekspertëve.

Ekspertët kontabël të autorizuar garantojnë që llogaritë vjetore janë të rregullta e të hartuara me sinqeritet dhe japin një pasqyrim besnik të rezultatit te opracioneve të vitit të kaluar financiar, si dhe gjendjes financiare e të trashëgimisë së shoqërisë në fund të këtij viti

financiar. Ata kanë për detyrë të përhershme, duke përjashtuar cdo nderhyrje në administrim, të verifikojnë librat e llogarisë dhe fondet e shoqërise si dhe të kontrollojnë përshtatjen e kontabilitetit të saj me legjislacionin në fuqi. Ata verifikojnë gjithashtu sinqeritetin dhe përputhjen me llogaritë vjetore të informacioneve të dhëna në raportin e administrimit nga ana e drejtorisë dhe në dokumentet që u janë dërguar aksionerëve mbi gjendjen financiare dhe llogaritë vjetore.

Ekspertët kontabël të autorizuar sigurohen që është respektuar barazia ndërmjet aksionarëve.

Ekspert kontabel emerohet Z. Artan Golemi.

Neni 10

Viti Financiar

Viti financiar i shoqërise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërise në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 11

Shkrirja dhe likuidimi

Perveç rasteve të parashikuara nga ligji, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerëve, mund të vendosë shkrirjen e parakohshme të shoqërise dhe venien e saj nën likuidim.

Për këto qëllime, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerëve do të përcaktojë procedurat dhe menyrat e likuidimit, duke zbatuar dhe respektuar ato që janë parashikimet e ligjit.

Mbledhja e Jashtezakonshme e Aksionerëve emeron një a me tëper likuidues, duke përcaktuar për secilin kompetencat dhe funksionet në kryerjen e procedurave të likuidimit.

AKSIONERET

Artur DOJAKA

Artur Dojaka



Ioakim BEDO

Ioakim Bedo



**STATUT
I SHOQERISE "AGROTAL 1" SHA**



Me cilesine e aksionereve themelues :

1. Aksioneri Artur Dojaka i biri i harunit i dtl.06.06.1970 lindur dhe banues ne Tirane mbajtes i pass nr.0321392.

2. Aksioneri Ioakim Bedo i biri i Jorgos i dtl.18.04.1964 lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane mbajtes i pass.Z1232508.

sipas aktit te themelimit te nenshkruar nga te gjithë aksioneret, mbeshtetur :

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,

Ne ligjin 7638 date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare "

Ne ligjin nr. 7667 date 28.01.1993, " Per regjistrin tregtar", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, eshte themeluar Shoqeria Anonime me emertimin " **AGROTAL 1** " sha.

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

KAPITULLI I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "AGROTAL 1 " sha, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri Anonime pa Oferte Publike (me poshte e quajtur "Shoqeria").

NENI 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në gjykatën kopetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimitarisë së saj.

Shoqëria "AGROTAL 1 " sha, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në aksione dhe që themelohet ndërmjet aksionereve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, Shqiperi, ne adresen Rr "Pjeter Bogdani i ri" godina 2-6 kate,kati 2 zyra nr.1.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Jashtëzakonshme.

Neni 4

Objekti

Agrobiznesit, prodhim dhe tregtim vaji, kultivim te ullirit dhe bimeve te tjera qe lejohen nga ligji. Import-eksport dhe tregtim me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, artikuj bujqesor dhe blegtorale, pajisje elektronike, elektrike, informatike, elektroshtepiake, metrazhe, lende kimike, bime medicinale.

Prodhim dhe tregtim te artikujve te ndryshme mobilerie, dyer, dritare, artikuj duralumini, tregtim pajisje zyre, kanceleri, apjisje ventilimi dhe kondicionimi.

Tregtim medikamentesh dhe barnash mjekesore, pajisje diagnostikuese dhe aparatura te ndryshme mjekesore.

Agjensi udhetimesh turistike. Agjensi imobiliare. Agjensi shitje biletash te transportit urban, hekurudhor, ajror dhe detar.

Realizimi I qellimeve te shoqerise mund te arrihet nga shoqeria vecmas ose ne bashkepunim me persona privat ose juridik te cfare do lloj forme, te cilet kane qellime te njejta ose te peraferta, brenda ose jashte vendit me pjesmarrjen e shoqerise ne forma te ndryshme juridike, te cilat ekzistojne ose do te themelohen, ose me bashkim me shoqeri te tjera qe kane qellime te njejta ose te peraferta.

Neni 5

Kohezgjitia

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqiptar.

KAPITULLI II.

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 2.000.000 Leke dhe eshte i ndare ne 2000 aksione me vlere nominale 1.000 (njemije) Leke shqiptare secili. Kapitali i shoqerise nenshkruhet dhe derdhet teresisht ne te holla nga aksioneret e shoqerise perkatesisht:

1. Aksioneri Artur Dojaka aksione me vlere te pergjithshme 1.000.000 Leke, qe perbejne 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Aksioneri Ioakim Bedo aksione me vlere te pergjithshme 1.000.000 Leke, qe perbejne 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kapitali i shoqerise mund te rritet dhe zvohelohet, sipas menyrave te parashikuara ne ligj.

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne njeh vlerh me te vogel se ajo e percaktuar ne paragrafin e pare, e ben te detyrueshme marrjen e njeh vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar te pakten deri ne vleren minimale. Ne te kundert shoqeria duhet te shnderrohet ne njeh forme tjetere. Ne rast moszbatimi te kerkesave te ketij paragarfi, chdo personi interesuar mund te kerkojeh ne rruges gjyqesore prishjen e shoqerise. Kjo prishje nuk mund te shpallet, ne qofte se rregullimi eshte bere ne diten kur gjykata mblidhet per te marre vendim.

Neni 7

Zmadhimi i kapitalit

Kapitali themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.

Aksionet e reja shlyhen me para në dorë, me kompensim të një kredie në para të kërkueshme dhe të detyruar për t'u shlyer nga shoqëria, me përfshirje të rezervave, fitimeve apo primeve të emetimit, me kontribut në natyrë ose me shndërrimin e obligacioneve. Zmadhimi i kapitalit nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve bëhet vetëm me pëlqimin unanimit të aksionarëve, me përjashtim të rastit kur ai realizohet me përfshirjen e rezervave, të fitimeve apo primeve të emetimit.

Asambleja e jashtëzakonshme është kompetentja e vetme për të vendosur në mbledhjen e saj zmadhimin e kapitalit mbi bazën e raportit të drejtorisë.

Në rast se zmadhimi i kapitalit realizohet me përfshirje të rezervave, të fitimeve ose primeve të emetimit, asambleja vendos sipas kushteve të quorumit dhe të shumicës të caktuara në nenin 129 të ligjit për shoqëritë tregtare.

Neni 8

Zvogëlimi i kapitalit

Zvogëlimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga asambleja e jashtëzakonshme në mbledhjen e saj, e cila mund t'i japë drejtorisë të gjitha kompetencat për ta realizuar.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek aksionarët në të njëjtën masë në përpjestim me vlerën e aksioneve që zotërojnë.

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, të paktën 45 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së aksionarëve që thirret për të vendosur mbi këtë projekt.

Asambleja merr vendim mbi raportin e ekspertëve kontabël të autorizuar, të cilët japin vlerësimin e tyre mbi shkaqet dhe kushtet e zvogëlimit.

Kur operacioni realizohet nga drejtoria, e cila është e ngarkuar nga asambleja, ajo harton një procesverbal që shpallet publikisht dhe vepron për ndryshimin përkatës të statutit.

Neni 9

Kontributet në natyrë

Në rastin e kontributeve në natyrë ose të pranisë së avantazheve të veçanta, me vendim gjyqësor caktohen një ose disa ekspertë për kontributet. Ata i nënshtrohen papajtueshmërive të caktuara në nenet 168 dhe 169 të ligjit për shoqëritë tregtare.

Ekspertët çmojnë, nën përgjegjësinë e tyre, vlerën e kontributeve në natyrë dhe avantazhet e veçanta. Raporti i hartuar prej tyre iu vihet në dispozicion aksionarëve në selinë e shoqërisë të paktën 8 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme, për të cilën zbatohen rregullat e nenit 87 të ligjit për shoqëritë tregtare.

Në rastin e miratimit nga Asambleja të vlerësimit të kontributeve, si dhe dhënies së avantazheve të veçanta, ajo pasqyron realizimin e zmadhimit të kapitalit.

Në rast se asambleja zvogëlon vlerën e kontributeve, si dhe shpërblimet që lidhen me avantazhet e

veçanta, atëherë kërkohet miratimi shprehimisht për këto ndryshime nga ana e kontribuesve, përfituesve ose mandatmbajtësve të autorizuar prej tyre. Në të kundërt, zmadhimi i kapitalit nuk realizohet. Aksionet për kontributet në natyrë shlyhen plotësisht sapo të emetohen.

Neni 10

Transferimi i pronësisë së aksioneve

Me përjashtim të rasteve të trashëgimisë, transferimi i pronësisë mbi aksionet një personi të tretë, pavarësisht nga baza juridike e këtij transferimi, duhet t'i nënshtrohet pëlqimit të shoqërisë. Shoqërisë i dorëzohet një kërkesë miratimi ku tregohen emri, mbiemri dhe adresa e personit që i transferohet pronësia, numri i aksioneve që parashikon transferimi i pronësisë dhe çmimi i ofruar. Miratimi konsiderohet i dhënë nëpërmjet një njoftimi ose kur nuk ka përgjigje brenda një afati 3-mujor nga data e kërkesës. Në qoftë se shoqëria nuk miraton personin e propozuar për transferimin e pronësisë, drejtoria detyrohet që brenda tre muajsh, që nga data e njoftimit të refuzimit, të blejë aksionet, nëpërmjet një aksioneri ose personi të tretë apo me pëlqimin e personit që humb pronësinë nga vet shoqëria, me qëllim të zvogëlimit të kapitalit. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve çmimi i aksioneve përcaktohet sipas dispozitave të nenit 11 të ligjit. Në qoftë se pas perfundimit të afatit prej 3 muajsh blerja nuk është realizuar, miratimi për transferimin e pronësisë konsiderohet i dhënë. Megjithatë ky afat mund të zgjatet me vendim gjyqi sipas kërkesës së shoqërisë.

KAPITULLI III

Neni 11

Asambleja e Aksionereve

Mbledhja e Asamblese së Aksionereve zhvillohet si në mbledhje të zakonshme ashtu edhe të jashtëzakonshme.

Mbledhjet e Asamblese së Aksionereve do të mbahen në seline të shoqërisë, apo kudo në territorin shqiptar, sipas marrëveshjes së aksionereve.

Njoftimi për mbledhjen e Asamblese së Aksionereve duhet të bëhet të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara, nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore, nëpërmjet një letre rekomande, telefaksi, dhe lajmerimi, në adresën e çdo aksioneri, i cili duhet të përcaktojë ditën, orën, vendin ku do të bëhet mbledhja, natyrën e zakonshme, të jashtëzakonshme, apo të veçantë si edhe rendin e ditës. Çdo mbledhje asambleje që thirret në mënyrë të parregullt, mund të anulohet.

Neni 12

Thirrja e Mbledhjes së Asamblese së Aksionereve

Asambleja e Aksionereve thirret nga Këshilli Mbikëqyrës ose nga Drejtoria.

Në mungesë ajo thirret gjithashtu nga ekspertët kontabël të autorizuar; nga një mandatmbajtës, i caktuar nga Gjykata; me kërkesën e çdo personi të interesuar për një rast urgjent; ose të një apo disa aksionarëve që zotërojnë së bashku të paktën 1/10 e kapitalit themeltar; nga likuiduesit.

Neni 13

Asambleja e Jashtëzakonshme

Asambleja e jashtëzakonshme ka kompetenca të ndryshoje statutin në të gjitha dispozitat e tij. Çdo klauzolë e kundërt konsiderohet e pavlefshme. Në rast ajo nuk mund të shtojë detyrimet e aksionerëve, përveç operacioneve që rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.

Asambleja e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në mbledhjen e parë të paktën 1/2 e aksioneve dhe në të dytën 1/4 e aksioneve me të drejtë vote. Në mungesë të këtij quorumi mbledhja e dytë e asamblesë mund të shtyhet për një ditë të mëvonshme, jo më të largët se dy muaj nga data e thirrjes së parë. Ajo merr vendim me një shumicë votash prej 3/4 që u përkasin aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës, anëtarët e drejtorisë dhe ekspertët kontabël të autorizuar mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e asamblesë së aksionarëve me vota konsultative. Ata duhet të njoftohen me shkrim brenda afatit që përcaktohet në nenin 133 të këtij ligji. Ata kanë votë vendimore vetëm kur e zotërojnë atë në cilësinë e aksionarëve.

Neni 14

Asambleja e Zakonshme

Asambleja e zakonshme e shoqërisë, thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar. Ky afat mund të zgjatet me vendim gjyqësor. Asambleja shqyrton dhe vendos mbi të gjitha çështjet financiare të vitit financiar që ka kaluar. Emeron anëtarët e këshillit mbikëqyrës kur numri I tyre ka zbritur nën minimumin ligjor, për të plotësuar efektivin e këshillit mbikëqyrës.

Asambleja e Zakonshme e Aksionereve mund të caktojë një shumë fikse vjetore si shperblim për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës për shërbimet e tyre.

Asambleja e zakonshme është kompetente për të vendosur për të gjitha çështjet e parashikuara sipas neneve 123, paragrafi 3, dhe 125 i ligjit për shoqëritë tregtare..

Ajo merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm në qoftë se aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë të paktën 1/4 e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën nuk kërkohet asnjë lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar.

KAPITULLI IV

Këshilli Mbikqyrës

Neni 15

Funksioni, Kompetencat

Këshilli mbikëqyrës ushtron kontroll të vazhdueshëm ndaj drejtorisë për administrimin dhe drejtimin e shoqërisë nga ana e saj. Këshilli mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikimet dhe kontrollet që ai i çmon të arsyeshme dhe të kërkojë të njihet me dokumentet që ai i gjykon të nevojshme për plotësimin e detyrës së tij.

Drejtoria i paraqet raport këshillit mbikëqyrës të paktën një herë në tre muaj. Brenda tre muajve

nga mbyllja e vitit financiar, drejtoria i paraqet këshillit mbikëqyrës dokumentet që përcaktohen në nenin 130, paragrafi 2 i ligjit për shoqëritë tregtare, me qëllim verifikimi dhe kontrolli.

Këshilli mbikëqyrës, në përputhje me nenin 130, i paraqet asamblesë vërejtjet e tij mbi raportin e drejtorisë, si dhe ato mbi llogaritë e vitit financiar.

Këshilli Mbikqyrës verifikon dhe kontrollon raportin e administrimit, raportin financiar vjetor dhe bilancin e paraqitur nga Drejtoria përpara se ato të paraqiten Mbledhjes së Zakonshme të Asamblese së Aksionereve për miratim.

Këshilli Mbikqyrës i paraqet ndër të tjera Asamblese së Aksionereve një raport specifik mbi mbarevejtjen e aktivitetit të shoqërisë.

Këshilli Mbikqyrës emeron dhe shkarkon Drejtorinë e Shoqërisë.

Neni 16

Numri i anetareve

Këshilli Mbikqyrës do të ketë 3 anetare.

Këshilli i parë Mbikqyrës do të ketë përberjen e mëposhteme:

1. Artur Dojaka (Kryetar)
2. Ioakim Bedo (N/Kryetar)
3. Laureta Qorlazja (Anetar).

Asnjë anëtar i këshillit mbikëqyrës nuk mund të jetë anëtar i drejtorisë. Në rast se një anëtar i këshillit mbikëqyrës do të emërohet anëtar i drejtorisë, mandati i tij në këshillin mbikëqyrës përfundon sapo ai të kalojë në funksionin e ri.

Neni 17

Emerimi, Zgjedhja dhe Kohezgjatja e Mandatit

Çdo person i caktuar si anëtar i Këshillit të parë Mbikqyrës në nenin e mësipërm të statutit, do të qëndrojë në këto detyra për 5 vjet.

Me përfundimin e kohezgjatjes së mandatit të caktuar në paragrafin e mësipërm të këtij neni, Mbledhja e Zakonshme e Asamblese së Aksionereve emeron anëtarët që do të përbejnë 2/3 e Këshillit të ri Mbikqyrës.

1/3 e anetareve të Këshillit të ri Mbikqyrës do të zgjidhet midis punonjësve të Shoqërisë.

Çdo anëtar i Këshillit Mbikqyrës do të qëndrojë në këto detyra për 3 vjet rresht. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës do të zgjedhin mes tyre Kryetarin dhe Zv/Kryetarin e Këshillit Mbikqyrës.

Neni 18

Shkarkimi

Çdo anëtar i emëruar i Këshillit Mbikqyrës mund të shkarkohet në çdo moment me vendim të Mbledhjes së Zakonshme të Asamblese së Aksionereve.

Neni 19

Vendi i Mbledhjeve

Këshilli Mbikqyrës mund t'i zhvillojë mbledhjet në vendin e përcaktuar rast pas rasti nga vete Këshilli Mbikqyrës. Në qoftë se vendi i mbledhjes nuk është caktuar, atëherë ky vend do të

jete selia e shoqerise (Neni 2 i ketij Statuti).

Neni 20

Njoftimi i Mbledhjeve

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres do te zhvillohen pas nje lajmerimi te bere 15 (pesembedhjte) dite perpara, ne daten dhe oren e caktuar rast pas rasti nga Keshilli Mbikqyres. Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres do te thirren nga Kryetari i tij, nepemjet nje njoftimi te bere çdo anetari nepermjet letres rekomande, telefonit, postes, postes elektronike ose me telegram ku percaktohet dita, ora, vendi dhe qellimi i mbledhjes.

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres do te drejtohen nga Kryetari, dhe ne mungese te tij, nga Zv/Kryetari.

Neni 21

Votimi

Vendimet e Keshillit Mbikqyres do te konsiderohen si te vlefshme vetem kur ne mbledhje te jene te pranishem te pakten gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm ose përfaqësuesve të tyre. Vota e kryetarit është përcaktuese, në rast rezultati të barabartë votash

Ne qofte se kuorumi nuk arrihet, shumica e anetareve te pranishem mund ta shtyjne mbledhjen duke percaktuar daten, oren dhe vendin.

Vendimet e Keshillit Mbikqyres duhet te hidhen te gjitha ne nje proces verbal te posaçem, te hartuar si ne gjuhen shqipe ashtu edhe ne gjuhen greke, dhe duhen te nenshkruhen nga anetaret e pranishem.

Neni 22

Pergjegjesite

Rastet e pergjegjesive te Anetareve te Keshillit Mbikqyres jane ato qe parashikohen shprehimisht nga ligji ne fuqi.

Ne rast se anetaret e Keshillit Mbikqyres kane dijeni per faje te bera nga anetaret e Drejtorise dhe nuk ia njoftojne ato Mbledhjes se Zakonshme te Asamblese se Aksionereve, konsiderohen pergjegjes per keto faje.

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë përgjegjës për gabimet personale të bëra në kohën e mandatit të tyre. Ata nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për shkak të veprimeve në administrim dhe të rezultateve të tyre.


KAPITULLI V

Drejtoria

Neni 23

Funksionet dhe Kompetencat

Drejtoria administron dhe drejton Pasurite dhe aktivitetin e Shoqerise dhe perfaqeson ligjerisht shoqerine. Drejtoria ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë.



Ajo i ushtron këto kompetenca brenda objektit të shoqërisë, por kufizohet nga ato kompetenca që ligji ua jep shperhimisht këshillit mbikëqyrës dhe asambleve të aksionarëve. Shoqëria në marrëdhëniet me të tretët merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e drejtorisë, edhe kur këto akte nuk përfshihen në objektin e shoqërisë. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i drejtorisë e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin se vetë shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e drejtorisë duhet të respektohen nga të tretët.

Drejtoresha është znj. Tamara Agolli.

Neni 24

Numri I anetareve te drejtorise.

Drejtoresha do te perbehet nga nje person i cili do te kete funksionet e Drejtorit.

Neni 25

Emerimi dhe Kohezgjatja e Mandatit.

Drejtori emerohet nga Keshilli Mbikqyrës me nje shumice votash, dhe do te qendroje ne detyre si i tille per nje periudhe prej 3 vjetesh.

Drejtori do te qendroje ne kete detyre deri ne momentin e shkarkimit apo heqjes dore nga detyra, sipas asaj ç'ka parashikon seksioni 4.

Neni 26

Shkarkimi

Drejtori mund te shkarkohet me shumice votash te Keshillit Mbikqyrës, për shkaqe të përligjura nga këshilli mbikëqyrës.

Si shkaqe të përligjura konsiderohen veçanërisht një faj I rëndë i anëtarit të drejtorisë, paaftësia e tij në kryerjen korrekt të funksioneve ose kur asambleja humbet besimin tek ai. Përfshihen rastet kur shkarkimi është nxitur haptazi nga shkaqe që s'kanë të bëjnë me interesimin e shoqërisë. Shkarkimi mbetet në fuqi derisa vendimi gjyqësor që evidencon pavlefshmërinë e shkarkimit të marrë fuqi ligjore. Kontrata e punës e të interesuarit vazhdon t'i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit shqiptar.

Neni 27

Pergjegjesite

Drejtori eshte pergjegjes per kryerjen e funksioneve te saj ndaj Keshillit Mbikqyrës dhe Mbledhjes se Zakonshme te Asamblese se Aksionereve.

Anëtarët e drejtorisë janë përgjegjës, individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të dispozitave ligjore ose rregulloreve të zbatueshme për shoqëritë anonime, për shkelje të statusit, si dhe për gabimet e bëra në administrimin e shoqërisë. Në qoftë se disa anëtarë të drejtorisë kanë bashkëpunuar në të njëjtat gabime, gjykata përcakton pjesën e secilit në kontributin për ndreqjen e dëmit.

Neni 28

Ekspertet Kontabel te Autorizuar

Mbledhja e Asamblese se Aksionereve, emeron nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar. Çdo ekspert kontabel i autorizuar do te qendroje ne kete detyre per nje vit financiar te shoqerise. Funkcionet e tyre përfundojnë pas mbledhje së asamblesë së zakonshme, e cila merr vendim mbi llogaritë vjetore. Eksperti kontabël i autorizuar, i emëruar nga asambleja për zëvendësimin e një tjetri, mbetet në funksion deri në fundin e mandatit të paraardhësit të tij. Në qoftë se asambleja lë pas dore zgjedhjen e një eksperti, çdo aksionar mund të kërkojë caktimin e një eksperti kontabël të autorizuar në rrugë gjyqësore; në këtë rast gjykata thërret sipas rregullave drejtorin e drejtorisë. Kështu mandati i caktuar përfundon kur mbledhja e asamblesë ka marrë masat për emërimin e një ose të disa ekspertëve.

Ekspertët kontabel të autorizuar garantojnë që llogaritë vjetore janë të rregullta e të hartuara me sinqeritet dhe japin një pasqyrim besnik të rezultatit të opracioneve të vitit të kaluar financiar, si dhe gjendjes financiare e të trashëgimisë së shoqërisë në fund të këtij viti financiar. Ata kanë për detyrë të përhershme, duke përjashtuar cdo nderhyrje në administrim, të verifikojnë librat e llogarisë dhe fondet e shoqërisë si dhe të kontrollojnë përshtatjen e kontabilitetit të saj me legjislacionin në fuqi. Ata verifikojnë gjithashtu sinqeritetin dhe përputhjen me llogaritë vjetore të informacioneve të dhëna në raportin e administrimit nga ana e drejtorisë dhe në dokumentet që u janë dërguar aksionerëve mbi gjendjen financiare dhe llogaritë vjetore. Ekspertët kontabël të autorizuar sigurohen që është respektuar barazia ndërmjet aksionarëve. Ekspert kontabel emerohet Z. Artan Golemi.

Neni 29

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.


Neni 30

Shperndarja e Fitimeve

Fitimi që do të shpërnahet, përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit ose statutit dhe, nga ana tjetër, janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshëm.

Asambleja mund të marrë vendim që të shpërndahen shumat e lëna mënjanë për rezervën që ajo ka në dispozicion. Në këtë rast vendimi tregon shprehimisht llojet e rezervës ku janë marrë këto shuma.

Përveç rastit të zvogëlimit të kapitalit asnjë shpërndarje nuk mund t'u bëhet aksionerëve, ne qoftë se kapitalet e veta janë, ose do të bëheshin mbas kësaj shpërndarje më të vegjël se shuma e kapitalit, të cilit i shtohen rezervat që ligji nuk i lejon të shpërndahen.



Neni 31

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve, miraton bilancin e pergatitur nga Drejtoria dhe te paraqitur nga Keshilli Mbikqyres. Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve, vendos rreth shperndarjes se dividendeve, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, sic parashikohet nga ligji, ne raport me aksionet e zoteruara nga secili prej Aksionareve.

Ps miratimit te llogarive vjetore dhe evidencimit te ekzistencës së shumave që do të shpërndahen, asambleja përcakton pjesën që u takon aksionarëve n formë dividendesh.

Çdo dividend i shperndarë, duke shkelur këto rregulla, përbën një dividend fiktiv.

Megjithatë nuk përbëjnë dividende fiktive paradhëniet, vlera e të cilave ka rrjedhur nga vitet financiare të mbyllura ose në vazhdim, të cilat janë derdhur përpara se të jene miratuar llogaritë e këtyre viteve financiare, me kusht që:

1. Shoqëria, veç rezervës së domosdoshme të ketë në dispozicion rezerva me një shumë të paktën të njëjtë me paradhëniet e shpërndara ose që një raport vërtetimi i bërë nga një ekspert kontabël i autorizuar të bëjë të njohur fitime neto më të mëdha se shuma e paradhënëve;
2. Shpërndarja e paradhënëve të vendoset nga drejtoria ose nga administratorët, që përcaktojnë shumën dhe datën e kthimit.

Neni 32

Rezerva Ligjore

Shoqëria nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar, pasi të jene zbritur po të jete e nevojshme humbjet e vitit të mëparshëm, lë mënjanë një shumë me vlerë të paktën 1/20 e tij, e cila destinohet për formimin e një fondi rezervë, të quajtur "rezervë e domosdoshme". Çdo vendim i kundërt është i pavlefshëm.

Kjo lënie mënjanë nuk është më e detyrueshme kur "rezerva e domosdoshme" arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Neni 33


Shkrirja dhe likuidimi

Shoqëria prishet automatikisht me përfundimin e afatit sipas statutit.

Perveç rasteve te parashikuara nga ligji, Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve, mund te vendose shkrirjen e parakohshme te shoqerise dhe venien e saj nen likuidim. Per kete qellim, Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve do te percaktoje procedurat dhe menytrat e likuidimit, duke zbatuar dhe respektuar ato ç'ka jane parashikimet e ligjit. Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve emeron nje a me teper likuidues, duke percaktuar per secilin kompetencat dhe funksionet ne kryerjen procedurave te likuidimit.

Neni 34

Prishja per humbje aktivi



Në qoftë se si rrjedhim i humbjeve të konstatuara në dokumentet kontabël kapitalet e veta të shoqërisë bëhen më të vogla se gjysma e kapitalit themeltar, drejtoria detyrohet, brenda 4 muajve nga miratimi i bilancit financiar ku është zbuluar kjo humbje, të thërresë mbledhjen e asamblesë së jashtëzakoshme, me qëllim që të merret vendimi, nëse ka vend për prishjen e shoqërisë. Në qoftë se prishja nuk shpallet nga shumica e nevojshme për ndryshimet e statutit, shoqëria detyrohet të zvogëlojë kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur të pambuluara nga rezervat dhe duke mbajtur parasysh dispozitat e nenit 75 të ligjit. Ky operacion duhet të kryhet jo më vonë se data e mbylljes së vitit të parë financiar para të cilit është konstatuar humbja, në qoftë se brenda këtij afati kapitalet e shoqërisë nuk janë plotësuar deri në një vlerë jo më të vogël se gjysma e kapitalit themeltar. Në të dy rastet zgjidhja e dhënë nga asambleja e përgjithshme publikohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore. Në mungesë të mbledhjes së asamblese së përgjithshme, ashtu dhe në rastin kur ajo asamble nuk ka mundur të marrë vendim të vlefshëm në mbledhjen e fundit, cdo i interesuar mund të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrugë gjyqësore. E njëjta gjë mund të bëhet në qoftë se nuk janë zbatuar dispozitat e paragrafit të dytë të këtij neni. Në të gjitha rastet gjykata mund t'i japë shoqërisë një afat maksimal prej 6 muajsh për të rregulluar gjendjen e saj; ajo nuk mund të shprehë prishjen, në qoftë se ditën kur merret vendimi ky rregullim është realizuar.

Neni 35

Shndërrimi I shoqërisë anonime.

Shoqëria mund të shndërrohet në shoqëri të një forme tjetër, në qoftë se në kohën e shndërrimit ajo ka të paktën dy vjet ekzistencë dhe në qoftë se ajo ka perpiluar dhe miratuar nga aksionarët bilancin e këtyre dy viteve të fundit financiare.

Neni 36

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në kete statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 37

Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tremeve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare. Ky statut mund të shtohet, ndryshohet ose të zevendesohet me një Statut të ri vetëm me vendim të Mbledhjes së Zakonshme të Asamblese së Aksionereve.

AKSIONERET

Artur DOJAKA

Artur Dojaka


Ioakim BEDO

Ioakim Bedo
